

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E MBROJTJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 217-25-5262-1-1-1

Sa i përket tenderit për; *Furnizim me radio jo taktike, bateri dhe UPS për nevojat e FSK-së*

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>InterAdria LLC</b>
NUI	<b>810819336</b>
Adresa	<b>Rr. Ali Kelmendi nr. 28</b>
Vendi	<b>Prishtine</b>
Kodi postar	<b>10000</b>
Numri Telefonit	<b>038246375</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>SHKUMBIN KAJTAZI</b>
Adresa elektronike	<b><u><a href="mailto:interadria@interadria-ks.com">interadria@interadria-ks.com</a></u></b>
Data e parashtrimit të kërkesës	<b>30.09.2025</b>

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Kërkesa për rishqyrtim 30.09.2025  
Vendimi mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim 01.10.2025  
Njoftim për Kontratë 12.06.2025 14:08  
Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues 25.09.2025 13:45

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

Po

Jo

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

Po

Jo

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Po

Jo

Sipas ligjit të prokurimit kompania jone "InterAdria LLC" ka bere Kërkesën per Rishqyrtim me datën 30.09.2025 ne përputhje me nenin 108A duke i ngritur pretendimet tona ankimore qe AK- Ministria e Mbrojtjes ta rishqyrtoj Njoftim Vendimin mbi dhënien e datës 25.09.2025.

AK i Ministrisë se Mbrojtës ka pezulluar rastin pas kërkesës për rishqyrtim, mirëpo nuk i ka marr për baze pretendimet tona se bashku me faktet/dëshmitë qe ja kemi dërguar qe ta rishqyrtoj Njoftim vendimin mbi dhënie. AK i Ministrisë se Mbrojtjes ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe nuk është përgjigjur asnjë pretendim ankimor qe ne si OE konsiderojmë se ka bere shkelje te rende te nenit 108A pasi nuk është përgjigjur asnjë pretendim ankimor ne baze te fakteve qe ju kemi ofruar ne si OE ankues.

### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Neni 7 - LPP - Barazia ne Trajtim/ Jo- Diskriminimi.  
Neni 51 Njoftimi i Krieteve të Përzgjedhjes  
Neni 52 Njoftimi i krieteve për dhënien e kontratës  
Neni 59 Vlerësimi tenderëve  
Neni 69 - LPP - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale  
Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve - RREGULLORE Nr.  
001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

### Pretendimi 1

Gjate shqyrtimit te dokumentacionit te ofertës se Operatorit Ekonomik te shpallur fitues, nuk i ka plotësuar kriteret e dosjes se tenderit siç kane qene te përcaktuara, qe një oferte te konsiderohet e përgjegjshëm ne baze te ligjit. Si OE ankues ne konstatojmë se komisioni i vlerësimit te ofertave gjate fazës se vlerësimit na ka diskriminuar kompaninë "InterAdria LLC" dhe ka favorizuar OE te rekomanduar pasi ka qene i pa përgjegjshëm dhe ne kundërshtim me nenin 7 te LPP-se. Pse po e citojmë këtë pasi kemi evidentuar disa mospërputhje serioze qe bien ndesh me kërkesat e dosjes se tenderit dhe sipas kërkesa te dosjes, OE te rekomanduar e bënë operator te papërgjegjshëm.

### Pretendimi 2

AK ne kërkesat e dosjes se tenderit te pika 7.1&7.2 ka kërkuar: *Kërkesa 7. Operatori ekonomik ne rast se nuk është vet prodhues atëherë duhet të ofroje dëshmi autorizimin nga prodhuesi apo dileri i autorizuar (MAF) nga prodhuesi për shitje te këtyre artikujve pjesë e këtij tenderi, OE nuk e ka autorizimin e prodhuesit nga prodhuesi Motorola qe bene furnizimin e radio jo taktike, bateri dhe UPS. Autorizimi qe ka dorëzuar me oferte nuk është i lëshuar nga Motorola por as nga dileri i tyre pasi nuk lejojnë ne asnjë diler tjetër si rishitës. Ne baze te kësaj ne kemi konstatuar se autorizim nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit dhe është i manipuluar pasi nuk është i lëshuar nga prodhuesi Motorola, ne kemi kërkuar nga prodhuesi Motorola Solutions Germany GmbH qe ju kemi drejtuar me një komunikim zyrtar qe ju kemi drejtuar na është përgjigjur se s'kemi asnjë autorizues tjetër si rishitës.*



Ju

**Interadria L.L.C.  
Ali Kelmendi No.28,  
Prishtina, 10000  
Kosovo**

To Whom It May Concern,

Motorola Solutions Germany GmbH hereby confirms that PartnerEmpower Program member permitted under any circumstances to authorize other resellers or third party companies to behalf of Motorola Solutions or to sublicense Motorola Solutions trademarks to any other c

Should you have any further questions, please reach out to your Channel Account Manager.

Yours sincerely,

**Nardo Swart  
Channel Sales Director**

Përkthim shqip:

Motorola Solutions Germany GmbH konfirmon se anetaret e programit PartnerEmpower nuk lejohen ne asnje rrethane te autorizojne rishites te tjere apo pale te treta per te vepruar ne emer te Motorola Solutions, apo per te nenlicencuar markat tregtare te Motorola Solutions per ndonje kompani tjeter.

Pra, duke u bazuar ne këtë konfirmim, dokumenti i paraqitur nga OE i shpallur fitues nuk është i vlefshëm, pasi është lëshuar nga një subjekt i paautorizuar dhe bie ndesh me kërkesat e përcaktuara ne dokumentet e tenderit. Gjithashtu përshkrimi i çmimit te OE te rekomanduar ku eshte kërkuar te ceket prodhuesi dhe origjina e produkteve vrahët qartë se nuk janë te prodhuesit qe e ka dorëzuar autorizimin e Motoroles, pra disa artikuj janë te prodhuesve tjerë.

Ne baze te fakteve dhe konstatimeve qe kemi ofruar me lart ne mendojmë se është i manipuluar autorizimi dhe duhet te vërteton AK i Ministrisë se Mbrojtje, përkundër fakteve qe i kemi ofruar ne kërkesën për rishqyrtim qe është i manipuluar autorizimi prap se prap nuk e kane vërtetuar ku një gjë te tille kërkohet me LPP-ne.

Duke u bazuar ne këto konstatime kompania jone konsideron se AK Ministria e Mbrojtjes ka bere shkelje te nenit 59 pasi nuk ka bere vlerësim real te ofertave dhe sic kërkohet me LPP-ne. Gjithashtu ne konstatojmë se AK-ja ka bere shkelje te nenit 52.7 te LPP-se, e ka pas për detyre te verifikoj dokumentet qe janë te manipuluar ne baze te nenit 52.7. Ne baze nenit 59 dhe 52.7 duhet te eliminohet kompania e rekomanduar "Tetroniks.L.L.C nuk e plotëson autorizimin. Ne si kompani e autorizuar kerkojm nga eksperti shqyertues i OSHP ta detyroj AK te Ministrisë se Mbrojtjes ta vërteton autorizimin e kompanisë se rekomanduar ose vet si ekspert ta vërteton me një email zyrtar nga OSHP-ja.

### Pretendimi 3

Sipas kriterëve te Dosjes se tenderit pika 9.1&9.2, operatori ekonomik duhet te paraqesë dëshmi për përfundimin me sukses te kontratave te natyrës se njëjtë apo te ngjashme, me vlere jo me pak se 190,000.00 €, brenda tre viteve te fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontrate.

Ne dokumentin e paraqitur nga OE fitues, me titull "Evidenca 10 – Lista e kontratave/referencave", janë listuar nëntë kontrata, asnjëra prej te cilave nuk ka te beje me natyrën e kësaj kontrate (radio komunikim). Kontratat e paraqitura lidhen kryesisht me:

Renovime objektësh,  
Furnizim me pajisje X-Ray scanner,  
Instalime barrierash, etj.

Nëse bazohemi ne nenin 69 te LPP-se Këto kontrata nuk mund te konsiderohen si te njëjta apo te ngjashme me objektin e këtij tenderi dhe si te tilla nuk përmbushin kërkesat teknike te dosjes se tenderit. Gjithashtu ne bazohemi ne UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK nenin 10 i këtij udhëzuesi e cek se nëse lista e kontratave/referencave nuk e përmbush kërkesat minimale te kërkesat e dosjes se tenderit duhet te refuzohet oferta.

Shih nenin 10 te UDHËZUES NR. 002/2024,

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
--	---	----

### Pretendim 4

Duke u bazuar ne objektin dhe natyrën e projektit dhe me kriteret ligjore te përcaktuara me LPP dhe RRPP konsiderojmë se kjo ofertë e OE te rekomanduar nuk përputhen ne asnjë me kriteret te DT dhe rregullat ligjore te lartcekura dhe as me proporcionali tetin ne relacion me lenden dhe përmasat e kontratës përkatëse, pra vlerësimi i ofertave nuk është ne përputhje me nenin 51 te LPP-se për faktin se vlerësimi i ofertave është hartuar dhe përshtatur me qellim qe te favorizoj OE te rekomanduar për kontratë. Favorizimi i tille ne procesin e vlerësimit duke mos respektuar kriteret e dosjes se tenderit ne këtë

mënyrë do të pengohet ose eliminohet konkurrenca e lire ne dom te pjesëmarrësve te OE tjerë.

Për këto arsye vlerësimi është ne kundërshtim te plotë me parimet e barazisë dhe dispozitat relevante ligjore nga neni 7, 51 dhe 69 te LPP dhe dispozitat e nenit 4(3), dhe 25 te RPPP m. 001/2024 ne fuqi pasi qe nuk siguron një balance-trajtim te drejt ne raport me objektin e lëndës përkatëse, por si i tillë e kufizon konkurrencën ne mesin e OE.

## V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik: "InterAdria LLC" lidhur me aktivitetin e prokurimit: *Furnizim me radio jo taktike, bateri dhe UPS për nevojat e FSK-së* me nr. te prokurimit: 217-25-5262-1-1-1 dhe Nr. i brendshëm: 217-25-080-1-1-1 te iniciuar nga AK- **MINISTRIA E MBROJTJES**

II. **ANULOHET** njoftimi B-58 per dhënie te aktivitetit te prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: *Furnizim me radio jo taktike, bateri dhe UPS për nevojat e FSK-së* me nr. te prokurimit: 217-25-5262-1-1-1 dhe Nr. i brendshëm: 217-25-080-1-1-1 te iniciuar nga AK- **MINISTRIA E MBROJTJES**, dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim** dhe pas rivlerësimit te shpallemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit.

### 9. Dëmet materiale

Shpenzime për oferte , shpenzimet për sigurim dhe shpenzimet tjera 2.500.00 €

### 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura